

VENDIM
Nr.404, datë 8.6.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT TË
HYRJE/DALJEVE NËPËRMJET PIKAVE TË KALIMIT KUFITAR QAFË-MORINË
(TROPOJË) – QAFË-MORINË (GJAKOVË), NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS, DHE PROTOKOLLIT TË KRYERJES SË
VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA NË KËTË PIKË TË KALIMIT KUFITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Qafë-Morinë (Tropojë) – Qafë-Morinë (Gjakovë), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, dhe protokollit të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këtë pikë të kalimit kufitar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha